REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

ASCAP



# PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMUATIZUAR "MËSUES PËR SHQIPËRINË" 2021

# PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR

Prill 2021

# TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES ........ 1
HYRJE ........ 2
QËLLIMI I PROGRAMIT ........ 3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT ........ 4
FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR ........ 4
FUSHA: DOKUMENTACIONI KURRIKULAR ........ 5
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE ........ 7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT ........ 9
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE ........ 10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E KURRIKULËS SË ARSIMIT PARASHKOLLOR ........ 10

# HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" për arsimin parashkollor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve (mësuesve) që do t'i nënshtrohen testimit "Mësues për Shqipërinë".

Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kërkesat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe për formimin e përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit (mësuesit). Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për kandidatët (mësuesit) që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumentacioni zyrtar[1]i cili lidhet me profesionin dhe shërben si rregullator në punën e përditshme të mësuesit për çdo institucion arsimor.
- Dokumentacioni kurrikular i arsimit parashkollor.
- Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë gjatë veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e kurrikulës së arsimit parashkollor.

[1]Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në institucionet arsimore duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

# QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve (mësuesve) të arsimit parashkollor është hartuar për të mbështetur e për të nxitur zhvillimin e tyre profesional, si dhe për t'u ardhur në ndihmë për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve (mësuesve) për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Zhvillimin e kompetencave profesionale, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë mësimore-edukative.
- Rritjen e përgjegjshmërisë për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në institucionin arsimor.
- Zbatimin me saktësi të rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.
- Rritjen e përgjegjshmërisë për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës parashkollore.
- Vlerësimin e aftësive shkencore, pedagogjike, metodike dhe etike të kandidatëve (mësuesve)që do të testohen.

# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve (mësuesve) të arsimit parashkollor është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, krahas kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë një mësues i arsimit parashkollor.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm nga kandidati (mësuesi), programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojë një mësues në fushën e njohurive dhe të aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

## FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR

| **Kompetenca**<br>**"Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor"** | **Literatura e rekomanduar** |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br><br>- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar;<br>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;<br>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e kopshtit; | - Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".<br>- Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"<br>- Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar". |

| | |
|---|---|
| - zotëron përmbajtjen e dokumentacionit parashkollor;<br>- *zbaton* udhëzimet e MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të veprimtarisë mësimore-edukative;<br>- zbaton etikën profesionale të mësuesit;<br>- respekton të drejtat dhe liritë e fëmijëve;<br>- respekton detyrat, të drejtat, përgjegjësitë dhe liritë e mësuesit;<br>- zbaton kërkesat e rregulloreve dhe të udhëzimeve për zhvillimin profesional të mësuesit. | - Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 "Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".<br>- Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve".<br>- Standardet profesionale të përgjithshme të mësuesit të arsimit parashkollor, MASR 2018.<br>- Udhëzimi nr. nr.4 datë 26.2.2021. "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve". |

# FUSHA: DOKUMENTACIONI KURRIKULAR

| **Kompetenca**<br>**"Zbatimi në mënyrë efektive i paketës së dokumenteve kurrikulare të arsimit parashkollor"** | **Literatura e rekomanduar** |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>- analizon kapitujt e Kornizës Kurrikulare të arsimit parashkollor dhe nxjerr në dukje risitë e filozofisë së re të kurrikulës;<br>- zbërthen dhe krahason treguesit e fushave të zhvillimit dhe të nxënit për secilën grupmoshë; | • Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor, MASR 2017.<br>• Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, MASR 2017.<br>• Kurrikula bërthamë klasa KP-5, IZHA 2014.<br>• Programet e arsimit parashkollor për 3-4-vjeçarët, MASR 2017. |

| | |
|---|---|
| - zbaton programet duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre;<br>- përshtat programet në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;<br>- përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programeve;<br>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në programe;<br>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e fëmijëve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;<br>- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve nga njëri grup në tjetrin);<br>- përzgjedh materialet dhe mjetet mësimore didaktike të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kërkesave të programeve;<br>- siguron informacion që demonstron integrimin ndërlëndor;<br>- analizon elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë programet e ndryshme edukative që zhvillohen në kopshtet shqiptare;<br>- gjen mënyra bashkëpunimi, partneriteti dhe bashkëveprimi ndërmjet kopshtit e prindërve të fëmijëve. | • Programet e arsimit parashkollor për 4-5-vjeçarët, MASR 2018.<br>• Programi i arsimit parashkollor për 5-6-vjeçarët, MASR 2019.<br>• Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor, MASR 2019<br>• Literaturë që ka në fokus aspekte të ndryshme të përmbajtjes, analizës, zbatimit të kurrikulës së parashkollorit. |

## FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE

| **Kompetenca I**<br><br>**"Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin parashkollor"** | **Literatura e rekomanduar** |
| --- | --- |
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br><br>- demonstron përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;<br>- mban parasysh karakteristikat e zhvillimit tërësor të fëmijëve të moshës 3-6-vjeçare;<br>- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të fëmijëve;<br>- demonstron respekt, besim dhe objektivitet me fëmijët;<br>- menaxhon situata, sjellje dhe veprime të ndryshme që paraqesin fëmijët;<br>- zbaton praktika pedagogjike në përshtatje me temën mujore, javore dhe ditore;<br>- identifikon fëmijët me nevoja të veçanta (me vështirësi në të nxënë dhe të talentuarit);<br>- motivon fëmijët me mënyra të ndryshme duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; | - Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.<br>- Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit në kopsht/ klasa përgatitore. |

| | |
|---|---|
| - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për fëmijët e grupit;<br>- ndihmon fëmijët për përzgjedhjen e punimeve që duhet të futen në portofolin e të nxënit, të cilat dëshmojnë interesin e tyre për të nxënë;<br>- prezanton materiale të ndryshme duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Word etj.;<br>- gjen dhe përdor materiale nga interneti për të pasuruar dhe lehtësuar të nxënit e fëmijëve. | |
| **Kompetenca II**<br>**"Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e integruar të arsimit parashkollor"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për përmbushjen e kompetencave kyçe, të treguesve të Standardeve të zhvillimit dhe të nxënit dhe të kompetencave të fushave të të nxënit;<br>- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur, krijues, imagjinatën dhe fantazinë e fëmijëve;<br>- planifikon mësimdhënien e integruar duke pasur në qendër të vëmendjes fëmijën; | - Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor, MASR 2019<br>- Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit në kopsht/ klasa përgatitore.<br>- Literaturë që ka në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. |

| | |
|---|---|
| - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;<br>- mat dhe vlerëson në mënyrë sistematike progresin e fëmijëve. | |

## FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

| **Kompetenca**<br>**"Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit"** | **Literatura e rekomanduar** |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>- njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, ndihmës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin;<br>- sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, ndihmës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat, 30.11.2013.<br>- Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit. |

## FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

| **Kompetenca**<br><br>**“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”** | **Literatura e rekomanduar** |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br><br>- njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;<br>- demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. | - Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. |

## FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E KURRIKULËS SË ARSIMIT PARASHKOLLOR

| **Kompetenca**<br><br>**“Zgjidhja dhe argumentimi shkencor i koncepteve lëndore që trajtohen në programet e arsimit parashkollor”** | **Literatura e rekomanduar** |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme**<br><br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br><br>- zotëron konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë që trajtohen në arsimin parashkollor në nivel shkencor dhe didaktik; | - Programet e arsimit parashkollor<br>- Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, IZHA, 2015.<br>- Botime ndihmëse për fëmijët dhe mësuesit parashkollorë, buletine dhe |

| | |
|---|---|
| - përshkruan përshkallëzimin vertikal dhe horizontal të koncepteve dhe të shprehive lëndore;<br>- transmeton te fëmijët parashkollorë ato njohuri, shprehi, aftësi dhe vlera që janë në përputhje me zhvillimin e tyre dhe me kërkesat e programeve;<br>- zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme ushtrime, kërkesa, situata problemore, eksperimente etj. | materiale të tjera burimore që trajtojnë përmbajtjen e kurrikulës për fëmijët parashkollorë. |

# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ASCAP




Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

*sekretaria@ascap.edu.al*


*www.ascap.edu.al*